

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. Regj.Them 7120/1179

Nr.Vendimit 7640

Data e regjistrimit 21.02.2017

Data 26.09.2018

VENDIM

Në emër të Republikës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Anila KARANXHA - Gjyqtare

asistuar nga sekretare seance **Ejvisa MOLLA**, sot më datë 26.09.2018, përfundoi në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin e çështjes civile me Nr.7120/1179 Akti me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: Shoqëria *** me NUIS ***, me zyrë qendrore të shoqërisë në ***L.1, me administrator **Z.** ***, përfaqësuar në gjykim nga **Av.** ***.

TË PADITUR:

- 1. Shoqëria** *** me NUIS ***, me zyrë qendrore të shoqërisë në ***, me administrator **Znj.** ***, përfaqësuar me autorizim nga **Znj.** *** dhe **Z.** ***. (në mungesë)
- 2. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale,** me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr.3, Tiranë, përfaqësuar me autorizim nga **Znj.** *** dhe **Z.** ***. (në mungesë)
Avokatura e Shtetit ka paraqitur relacion mospjesëmarrje.

OBJEKTI:

1. Deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë ***.
2. Detyrimin e DPPI të kryejë ç’regjistrimin nga regjistri i DPPI, të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë *** në emër të të paditurit.
3. Detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “****” SHPK, të ndalojë përdorimin dhe publikimin e markës tregtare “****” SHPK në ambientet ku ushtron veprimtarinë e saj.”

BAZA LIGJORE: Neni 140, Neni 143, Neni 144, Neni 156 i ligjit Nr. 9947 “ Për pronësinë industriale”, neni 35 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata në përfundim të gjykimit pasi administroi provat shkresore, dëgjoji palën paditëse në pretendimet e saj përfundimtare, e cila kërkoi pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj, pala e paditur në mungesë.

Si shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Se, paditësi shoqëria “****” SHPK i është drejtuar kësaj gjykate, me kërkesëpadinë me objekt: *“1. Deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë ***. 2. Detyrimin e DPPM të kryejë ç’regjistrimin nga regjistri i DPPM, të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë *** në emër të të paditurit.”*

Në seancën gjyqësore të datës 02.11.2017, pala paditëse kërkoi shtimin e objektit të kërkesëpadisë duke shtuar pikën e tretë, si dhe duke saktësuar në dy pikat e para se termin “DPPM” në “DPPI”. Gjykata, bazuar në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi pranimin e kërkesës së palës paditëse pasi është në disponibilitetin e saj të disponojë mbi objektin e padisë, në kushtet kur shkaku ligjor mbetet i pandryshuar. Objekti i ndryshuar i kërkesëpadisë është: *“1. Deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë ***. 2. Detyrimin e DPPI të kryejë ç’regjistrimin nga regjistri i DPPI, të markës tregtare *** me Nr. *** regjistrimi, datë *** në emër të të paditurit. 3. Detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “****” SHPK, të ndalojë përdorimin dhe publikimin e markës tregtare “****” SHPK në ambientet ku ushtron veprimtarinë e saj.”*

Gjatë gjykimit të kësaj çështje civile, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.17/2017, datë 16.02.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”, në nenin 1 të të cilit parashikohet se: *“Kudo në ligj, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave” (në vijim DPPM) zëvendësohet me “Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale” (në vijim DPPI).”* Në këto rrethana juridike, u saktësua emri i të paditurit “Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave” (DPPM) në Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI).

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje të paraqitur për gjykim dhe bazuar në nenet 36 dhe 59 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore dhe atë tokësore, në bazë të: nenit 41 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”*; nenit 348 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.”*, si dhe pikës 17 të nenit 4 të Ligjit Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji Nr.9947/2008”), i cili parashikon se *“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:...“Gjykatë” është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.”*

gjykata vlerëson se është kompetente për të shqyrtuar këtë çështje civile.

Pala paditëse, bazuar në nenin 32/a të Kodit të Procedurës Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me këtë kërkesëpadi, në bazë të së cilës do të përfitojë të drejta personale pasurore. Në bazë të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

RRETHANAT E FAKTIT

Në datën *** është themeluar shoqëria “****”, me NUIS ***, me administrator Z. *** me objekt aktiviteti “Bar restorant”.

Në vitin ***, shoqëria “****” ka regjistruar në pronësi të saj dy marka, përkatësisht:

- Marka *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë dhe figurë”, e cila përbëhet nga: zogj të stilizuar, rrathë që përmbajnë paraqitje të kafshëve, pjesë të organeve të tyre ose të bimëve, gërma të paraqitura në një formë të veçantë shkrimi. Kërkesa për regjistrimin e markës është depozituar në datën *** dhe është regjistruar në datën *** me datë mbarimi ***. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është regjistruar marka është: “42 – shërbime për rezervime, kafene, kafeteri, shërbim bufe, shërbime koktejtash, shërbime për takime dhe organizime të ndryshme, dhënie veshjesh me qera, dhënie veshje mbrëmjtash me qera, ekspozita, shërbime për kampe pushimi, shërbime konvaleshence, shërbime turistike, bujtina, shërbime klubi (koktejt), restorante, restorante (vetshërbim), shërbime ngrënie të shpejtë dhe pijesh, përkthim.”

Marka e regjistruar paraqitet si më poshtë:

- Në po të njëjtat data respektivisht, datë depozitimi *** dhe datë regjistrimi ***, me datë mbarimi ***, për të njëjtat mallra dhe shërbime ka regjistruar edhe Markën me Nr. ***.

Marka e regjistruar është si më poshtë:

Në datën *** është themeluar shoqëria “****” SHPK, pala paditëse në këtë gjykim, me NUIS ***, me zyrë qendrore të shoqërisë në ***, me administrator *** me objekt të aktivitetit: “Bar restorant, në fushën e tregtisë, import - eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimore, industriale, elektrike etj.”

Në datën ***, pala paditëse, *** SHPK ka depozituar kërkesën për regjistrimin e markës së saj: *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë dhe figurë”, e cila mbron ngjyrat blu, të bardhë dhe të kuqe, e përbërë nga: një delfin, viza të drejta, të valëzuara, gërma të lidhura me element figurativ, gërma të nënvizuara që mbivendosen, përshtaten ose ndalohen nga një ose më shumë goditje, me dy ngjyra mbizotëruese. Kërkesa për regjistrimin e markës është depozituar në datën *** dhe është regjistruar në datën *** me datë mbarimi ***. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është regjistruar marka është: “43 - Hotel; motel,

dhënie me qira të pajisjeve për restorante. Restorant, self-service, (vetëshërbim); Snack bar, bar. Dhënie me qira salla për konferenca, dhënie me qira të ambjenteve për akomodim të përkohshëm.” Elementët që përjashtohen nga mbrotja e kësaj marke është “*** BAR RESTORANT”.

Marka e regjistruar është si më poshtë:

Kjo markë është ripërtërirë në vitin 2017, fakt ky që provohet me shkresën Nr. ***, datë 29.09.2017, Çertifikatë ripërtëritje regjistrimi markë, lëshuar nga pala e paditur DPPI, dhe ka si datë mbarimi datën ***.

Në datën ***, midis shtetasve *** dhe *** në cilësinë e shitësit dhe shtetasit *** në cilësinë e blerësit është lidhur kontrata e shitjes Nr. ***, datë ***. Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se shitësi *** ka deklaruar se është pronar i vetëm i një objekti të quajtur “****” në ***, pronë kjo e e hipotekuar në regjistrin hipotekor me Nr***, datë ***, pasuri me Numrat ***, ***, ***, ***, me sipërfaqe prej *** m2, zona kadastrale *** pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Këto pasuri rezultojnë në pronësi të shtetasit ***. Nëpërmjet kontratës së shitjes palët kanë rënë dakord që shitësi ti shes blerësit: objektin “BAR RESTORANT ****” së bashku me truallin si dhe me interjerin ekzistues si dhe çdo pajisje dhe makineri ndihmëse. Po ashtu, nga përmbajtja e kontratës rezulton se blerësi, shtetasi *** ka deklaruar se pas blerjes së objektit prej tij, ai do të ruajë destinacionin që ka aktualisht sot, duke ruajtur veçanërisht emërtimin “BAR RESTORANT ****”.

Në datën *** është themeluar shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK, pala e paditur në këtë gjykim, me NUIS ***, me zyrë qendrore të shoqërisë në ***, me objekt të aktivitetit: “Bar restorant, hoteleri, import- eksport, tranzitim mallrash etj.”

Në datën *** ka mbaruar afati i mbrojtjes së markave në pronësi të shoqërisë “**** me Nr. Regjistrimi *** dhe ***. Për këto marka nuk rezultoi të jetë paraqitur ndonjë kërkesë për ripërtëritje, ndaj që nga data *** deri aktualisht janë marka të skaduara.

Në datën ***, pala paditëse, shoqëria “****” SHPK ka depozituar për regjistrim në pronësi të saj markën: *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë dhe figurë”, e cila mbron ngjyrën blu, me gërma të theksuara në ngjyrën blu, markë e cila është regjistruar në datën *** me datë mbarimi ***. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është regjistruar marka është: “43 - Hotel; motel, dhënie me qira të pajisjeve për restorante. Restorant, self-service, (vetëshërbim); Snack bar, bar. Dhënie me qira salla për konferenca, dhënie me qira të ambjenteve për akomodim të përkohshëm.”

Marka e regjistruar është:

Në datën ***, pala e paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK ka depozituar për regjistrim në pronësi të saj markën: *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë standarte”, e cila është regjistruar në datën *** me datë mbarimi ***. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është regjistruar marka është: “43- Shërbime të akomodimit të përkohshëm, shërbime bari, shërbime restoranti”. Kjo markë është botuar në faqen 65 të Buletinit të Pronësisë Industriale Nr. ***, datë ***, fakt ky, i cili provohet me shkresën kthim përgjigje Nr. *** datë *** të palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (sot DPPI). Pala paditëse, shoqëria “****” SHPK pretendon se regjistrimi i markës Nr. regjistrimi ***, i llojit “Fjalë standarte”, me datë regjistrimi *** dhe datë mbarimi *** cenon të drejtat e markës së tij me Nr. Regjistrimi ***, datë regjistrimi ***.

E DREJTA E ZBATUESHME

1) Ligj Nr. 9947/2008 “Për pronësinë industriale.”

- Neni 140 parashikon se: *“Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta: a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik; b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.”*
- Neni 141 parashikon se: *“1. Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre. 2. Karakteri dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t’i dallojë.”*
- Neni 143 parashikon se: *“1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme. 2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur: b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjllshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, te publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit. 6. Kriteret në lidhje me markat e mirënjohura përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.”*
- Neni 144 parashikon se: *“E drejta për markë E drejta ekskluzive për markat, sipas këtij ligji, fitohet nëpërmjet regjistrimit të tyre në DPPI.”*
- Neni 184/a parashikon se: *“1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të*

drejtave, sipas këtij ligji, i përket: a) pronarit të një patente, disenoje ose markë të regjistruar...”

2) Ligj Nr.7819/1994

- Neni 85 i Ligjit Nr.7819/1994 (Ndryshimi në pronësi) parashikon se: *“Në rastin kur ka ndryshime në vetë personin e pronarit të markës së regjistruar, kërkesa për shënimin e ndryshimit nga Zyra në regjistrin e saj të markave bëhet në formën e një komunikimi të nënshkruar nga pronari i markës së regjistruar ose përfaqësuesi i tij ose nga personi i cili fiton pronësinë (pronari i ri) ose përfaqësuesi i tij, duke treguar në këtë komunikim numrin e regjistrimit për të cilin bëhet fjalë dhe ndryshimin që do të shënohet.”*
- Neni 87 i Ligjit Nr.7819/1994 (Kontratë liçense) parashikon se: *“(1) Në kontekstin e këtij Ligji “me Kontratë Liçense” kuptohet çdo kontratë, me anë të së cilës pronari i një marke të regjistruar (“liçensori”) i jep palës tjetër (“të liçensuarit”) miratimin, që kjo palë të kryejë në vendin e tij çdo njërin nga aktet që përmenden në Nenin 85 të këtij Ligji, përsa i përket markës së regjistruar. (2) Kontrata e Liçensës duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga palët në kontratë, përndryshe kontrata nuk do të jetë e vlefshme. (3) Kontrata e liçensës e përfunduar, duhet të shënohet në regjistrin e markave kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. I liçensuari ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës lidhur me kontratën e liçensës, vetëm në rast se ajo është e regjistruar në regjistrin e markave.”*
- Neni 88 i Ligjit Nr.7819/1994 (Pavlefshmëria e kontratës së liçensës) parashikon se: *“Kontrata e Liçensës nuk është e vlefshme, në rastin kur ajo nuk përmban detyrimet që liçensori i vë të liçensuarit për të siguruar kontrollin efektiv të cilësisë së mallrave apo të shërbimeve, për të cilat përdoret marka e regjistruar.”*

VLERËSIMI I GJYKATËS

Gjykata çmon se për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje tregtare midis palëve ndërgjyqëse duhet t’i japë përgjigje pesë pyetjeve kyçe, si më poshtë:

1. A kanë kaluar markat me Nr.regjistrimi *** dhe ***, të regjistruara në pronësi të shoqërisë “**** tek pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ***” SHPK me anë të kontratës së shitblerjes Nr. ***, datë ***?
2. Cila palë ndërgjyqëse gëzon emrin tregtar “****”?
3. A gëzon mbrojtje marka “****”, duke qenë se përbëhet nga një fjalë e fjalorit të zakonshëm në gjuhë të huaj?
4. A ekzistojnë shkaqe për deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare *** me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT ***” SHPK?
5. A është marka me Nr. regjistrimi ***, në pronësi të palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT ***” SHPK, markë e mirënjohur?

Problemi i parë: A kanë kaluar markat me Nr.regjistrimi *** dhe ***, të regjistruara në pronësi të shoqërisë “****” SHPK tek pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ***” SHPK me anë të kontratës së shitblerjes ***,

datë *?**

Gjykata çmon se për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, duhet t'i referohemi ligjit material të kohës kur është kryer veprimi juridik, Kodit Civil si dhe neneve 85, 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 7819, datë 27.4.1994 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, (në vijim "Ligji Nr.7819/1994").

Në rastin konkret, në gjykim u vërtetua se në datën ***, midis shtetasve ***dhe *** në cilësinë e shitësve dhe shtetasit *** në cilësinë e blerësit është lidhur kontrata e shitjes Nr. ***, datë *** (në vijim "kontrata e shitjes"). Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se shitësi *** ka deklaruar se është pronar i vetëm i një objekti të quajtur "BAR RESTORANT ***" në ***, pronë kjo e hipotekuar në regjistrin hipotekor me Nr. ***, datë ***, pasuri me Numrat ***,***,***,***, me sipërfaqe prej *** m², zona kadastrale *** pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Këto pasuri rezultuan në pronësi të shtetasit ***. Nëpërmjet kontratës së shitjes palët kanë rënë dakord që shitësi ti shes blerësit: objektin "BAR RESTORANT ***" së bashku me truallin, si dhe me interjerin ekzistues si dhe çdo pajisje dhe makineri ndihmëse. Po ashtu, nga përmbajtja e kontratës rezulton se blerësi, shtetasi *** ka deklaruar se pas blerjes së objektit prej tij, ai do të ruajë destinacionin që ka aktualisht sot, duke ruajtur veçanërisht emërtimin "BAR RESTORANT ***".

Gjykata nga përmbajtja e kësaj kontrate konstaton se palët kontraktore janë persona fizikë, individë, konkretisht *** dhe *** në cilësinë e shitësit dhe *** në cilësinë e blerësit. Objekt kontrate ka qenë shitja e një pasurie të paluajtshme, e cila figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit ***, e për shkak të ligjit prezumohet edhe në emër të shitëses tjetër, bashkëshortes së tij ***. Në këtë kontratë objekti i tjetërsuar është përcaktuar, konkretisht: objekt, truall, interjeri ekzistues si dhe pajisjet e makineritë ndihmëse.

Sipas nenit 659 të Kodit Civil kontrata është një veprim juridik i dyanshëm, me anën e së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike civile. Kur vullneti i kundërt i palëve në kontratë përputhet atëherë kontratë konsiderohet e lidhur.

Në gjykim u vërtetua që pronare e markave me Nr.regjistrimi *** dhe ***, ka qenë Shoqëria "****" SHPK dhe jo palët kontraktore që kanë qenë në cilësinë e shitësve *** dhe bashkëshortja e tij ***. Po kështu në gjykim u vërtetua nga ekstrakti i lëshuar nga QKB se shoqëria "BAR RESTAURANT ****" SHPK, nuk ishte themeluar dhe regjistruar akoma në momentin që është lidhur kontrata e shitjes, kështu që nuk ka qenë palë kontraktore, por palë kontraktore ka qenë personi fizik blerësi ***. Sipas nenit 29 të Kodit Civil shoqëritë tregtare fitojnë personalitet juridik që nga data e regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Gjykata çmon se në rastin konkret, nga përmbajtja e kontratës së shitjes rezulton se mungon shfaqja e vullnetit (nuk ka një përputhje vullneti) për tjetërsimin e markave në pronësi të shoqërisë "****" SHPK me Nr.regjistrimi *** dhe ***, dhe palës së paditur Shoqëria "Bar Restaurant ****" ShPK, për aq kohë sa këta persona juridikë nuk kanë qenë palë kontraktore në këtë kontratë.

Gjykata po nga përmbajtja e kontratës së shitjes vlerëson se markat tregtare Nr.regjistrimi *** dhe *** nuk kanë qenë objekt i kësaj kontrate shitjeje, pasi nuk rezulton të jetë komunikuar në regjistrin e markave të Zyrës një ndryshim i pronësisë së markave, siç parashikohet në nenin 85 të ligjit Nr.7819/1994. Gjithashtu, gjykata vlerëson se parashikimi kontraktor "blerësi deklaroi se pas blerjes së objektit prej tij, ai do të ruajë destinacionin që ka aktualisht sot, duke ruajtur veçanërisht emërtimin "BAR RESTORANT ***" nuk mund të

interpretohet as si një kontratë liçensimi të markës. Referuar neneve 87 dhe 88 të ligjit Nr.7819/1994, që të jemi përpara një kontratë liçensimi të markës, përmes të cilës pronari i markës jep miratimin e përdorimit të markës së tij nga një person tjetër i liçensuar, është e nevojshme që kontrata e liçensimit të përmbush dy kushte kumulative: (1) forma shkresore e kontratës; dhe (2) të përmbajë detyrimet që liçensori i cakton të liçensuarit për të siguruar kontrollin e cilësisë së mallrave apo të shërbimeve, për të cilat përdoret marka e regjistruar. Në rastin konkret, gjykata konstaton se kontrata e shitjes nuk përmban detyrime për palën e paditur që të sigurojë kontrollin e cilësisë së mallrave apo të shërbimeve, për të cilat përdoret marka e regjistruar. Gjithashtu rezulton se Markat me Nr. regjistrimi *** dhe *** nuk përmbajnë togfjalëshin “Bar restorant ***” por respektivisht “Restorant ***” dhe “****”.

Gjykata vlerëson se deklarimi i blerësit, shtetasit ***, në kontratën e shitjes se ai pas blerjes së objektit do ruajë emërtimin dhe destinacionin e tij, nuk mund të barazohet me një veprim juridik tjetërsim i markës tregtare. Për tjetërsimin e markës tregtare, do duhej që të plotësoheshin dispozitat e përgjithshme të Kodit Civil që rregullojnë kontratat. Në rastin konkret, nuk kemi një objekt të caktuar me të dhënat e çdo marke të tjetërsuar. Madje termi “markë tregtare” nuk përmendet në kontratë. Po ashtu, as çmimi i paguar si shpërblim për “markën” nuk është i përcaktuar, ndërkohë që kontrata e shitjes, e cila ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte realizohet kundrejt pagimit të një çmimi. Nga ana tjetër, edhe nëse do të ishte përcaktuar objekti i shitjes (markat tregtare) konkretisht dhe çmimi i tyre, do duhej që shitja të realizohej nga pronari i tyre, pra shoqëria “****” SHPK, dhe jo shtetasit *** dhe ***.

Gjykata çmon se shoqëritë tregtare funksionojnë nëpërmjet organeve të tyre që në rastin konkret shoqëria “****” SHPK ka pasur si organe Asamblesë dhe Administratorin. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se për tjetërsimin e markave tregtare Nr. regjistrimi *** dhe *** në pronësi të shoqërisë duhej të merrej një vendim nga organet e shoqërisë.

Duke pasur në konsideratë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare, në kuadër të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, gjykata iu drejtua Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të kërkuar informacion nëse ka ndonjë vendim të Asamblesë së shoqërisë “****” SHPK për shitjen e pasurisë “BAR RESTORANT ***”, apo për shitjen e markave tregtare.

Referuar shkresës kthim përgjigje Nr.7160/1, datë 02.07.2018 të QKB-së, rezultoi se figuron i regjistruar një subjekt me NUIS (NIPT) ***, me emrin ***, me formë ligjore: SHPK, me administrator ***, i transferuar në QKR (sot QKB) nga organet tatimore. Ky subjekt nuk e ka kryer plotësimin e Ekstraktit historik dhe nuk mund të identifikohet vendimi i gjykatës mbi bazën e të cilit është regjistruar ky NUIS (NIPT) pasi ky subjekt është regjistruar përpara krijimit dhe funksionimit të QKB-së (data e regjistrimit, si e dhënë e transferuar nga organet tatimore është ***). Për këtë subjekt me NUIS (NIPT) *** rezultoi se është vetëm një aplikim me Numër ***. Ky aplikim, i cili mban datën ***, kishte për qëllim ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, ***, me datë themelimi ***, lidhur me selinë e shoqërisë, e cila kishte për adresë ***, dhe bëhet ***. Pra, për këtë shoqëri tregtare nuk rezultoi asnjë vendim i Asamblesë së Përgjithshme për tjetërsimin e markave tregtare Nr. regjistrimi *** dhe ***, të cilat rezultojnë se kanë qenë në pronësi të shoqërisë *** SHPK.

Gjithashtu, gjykata vëren se pala paditëse nuk ka ngritur pretendime ndaj markave me

Nr.regjistrimi *** dhe *** në pronësi të kompanisë ***, por pretendimet për cenimin e së drejtës i pretendon kundrejt markës me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur, si një markë e regjistruar më vonë sesa markat në pronësi të palës paditëse.

Edhe nëse markat në pronësi të shoqërisë “****” SHPK do t’i ishin transferuar palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT ****” SHPK, gjykata konstaton se markat me Nr. regjistrimi *** dhe *** kanë patur afat vlefshmërie 10 vjet nga data e depozitimit të tyre, pra deri më datë 07.04.2013. Referuar pikës 2 dhe 4 të nenit 164 të ligjit Nr.9947/2008, (si ligji i zbatueshëm në kohën kur për markat me Nr. regjistrimi *** dhe *** ka lindur e drejta për të paraqitur kërkesën për ripërtëritjen e markës), nëse pronari i markës nuk depoziton kërkesën për ripërtëritjen e saj ose nuk paguan tarifën përkatëse, në një periudhë jo më vonë se gjashtë muaj nga data e përfundimit të periudhës dhjetëvjeçare të regjistrimit marka në fjalë bëhet e pavlefshme. Referuar shkresave Nr. ***dhe Nr. ***, datë 11.04.2017 rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me kërkesën e palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT ****” SHPK, ka lëshuar dublikatë për markat me Nr.regjistrimi *** dhe ***, të cilat rezultojnë në pronësi të Kompanisë ***, Rruga *** dhe janë të skaduara, pasi nuk është bërë ripërtëritja e tyre.

Për sa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se markat me Nr.regjistrimi *** dhe ***, të regjistruara në pronësi të shoqërisë “*” SHPK aktualisht të cilave i ka mbaruar afati i mbrojtjes, nuk kanë kaluar tek pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK me anë të kontratës së shitblerjes Nr. ***, datë ***.***

Problemi i dytë: Cila palë ndërgjyqëse gëzon emrin tregtar “**”?**

Gjykata vlerëson se emri tregtar ose emri i biznesit përdoret me qëllim identifikimin e shoqërisë tregtare dhe shërben si emër për të, ndërsa, marka tregtare ose ajo e shërbimit përdoret për të identifikuar mallrat ose shërbimet që ofron një shoqëri tregtare. Megjithatë, një emër tregtar mund të shërbejë si një markë tregtare ose shërbimi në varësi të kontekstit në të cilin ajo përdoret. Një shoqëri mund të ketë shumë marka tregtare ose shërbimi, por vetëm një emër tregtar të regjistruar.

Funksionet e një marke tregtare ose shërbimi lidhen kryesisht me: përcaktimin e burimeve ose origjinën e mallrave dhe shërbimeve; garantimin e konsumatorëve mbi cilësinë e mallrave që përfaqëson marka; krijimin e një emri të mirë të biznesit dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të; mundësimin e konsumatorëve të marrin vendime pasi janë të informuar dhe të arrijnë të bëjnë dallimi midis mallrave/shërbimeve dhe shoqërive tregtare konkurruese; mbrojtjen e investitorëve në reputacionin e tyre, etj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK pretendoi se marka e palës paditëse me Nr. *** cënon emrin tregtar të shoqërisë “****” SHPK, emër ky i blerë nga pala e paditur në vitin 2007, nëpërmjet kontratës së shitjes Nr. ***, datë ***.

Gjykata konstaton se pala paditëse, shoqëria “****” SHPK ka të regjistruar si emër tregtar emrin “****”, ndërsa pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK ka të regjistruar si emër tregtar emrin “BAR RESTAURANT ****”, fakte këto që vërtetohen nga përmbajtja e ekstrakteve respektive të palëve ndërgjyqëse të regjistruar në QKB. Pra, rezulton se emri tregtar “****” gëzohet nga pala paditëse, shoqëria “****” SHPK, dhe jo pala e paditur shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK, pasi kjo e fundit përbëhet nga tri fjalë: bar,

restaurant dhe ***.

Përsa i përket pretendimit se palës së paditur, i ka kaluar e drejta e emrit tregtar “****” nga shoqëria “****”, nëpërmjet kontratës së shitjes Nr. ***, datë ***, gjykata vlerëson se siç u argumentua më sipër nuk kemi tjetërsim të emrit tregtar apo të markave të regjistruara në pronësi të shoqërisë “****” SHPK por vetëm një deklaram të shtetasit *** mbi mënyrën sesi ai do të quante objektin e blerë.

Megjithatë, edhe deklarimi i këtij të fundit nuk lidhet me emrin tregtar “****”, por me emrin “Bar restorant ****”. Rezulton se edhe emri tregtar i shoqërisë “****” SHPK është “****”, ndaj në këto kushte, nuk kishte sesi t’i transferonte palës së paditur, emrin tregtar “****”.

Në interpretim të pikës së parë të nenit 11 të ligjit nr.7632, datë 04.11.1992 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”, i cili parashikon se: *“Personi që vazhdon një veprimtari tregtare të një personi tjetër, mund të ruajë përdorimin e të njëjtit emërtim, me kusht që të shtojë në këtë emërtim një shënim, i cili ka të bëjë me transferimin.”*, gjykata konstaton se pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK kishte barrën e provës që të provonte se termi “****” është emri i saj tregtar, i transferuar nga shoqëria “****” SHPK, dhe që këtij emri tregtar i ishte shtuar një shënim që faktonte transferimin. Pala e paditur nuk provoi pretendimin e saj mbi kalimin e të drejtës së emrit tregtar nga shoqëria “****” SHPK me anë të kontratës së shitblerjes. Gjithashtu gjykata rithekson se Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK, ka fituar personalitet juridik pas lidhje së kontratës së shitjes dhe e drejta e emrit tregtar nuk ka mundësi t’i ketë kaluar nëpërmjet kësaj kontrate shitje.

Pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK pretendoi se bazuar në nenin 143/3/a të ligjit Nr.9947/2008, i cili parashikon se: *“Marka nuk mund të regjistrohet ose nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme të fituara, si: a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;..”* markat e regjistruara të palës paditëse duhet të deklarohen të pavlefshëm.

Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar për arsyet që do parashtrohen më poshtë:

Së pari: Pala e paditur nuk mund të ngrejë pretendime në formën e prapësimit. Referuar praktikës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në një gjykim të filluar, i padituri mund të përdor për t’u mbrojtur, sipas disponimit të tij, mjetet të caktuara, të cilat i paraqet proceduralisht nëpërmjet prapësimeve dhe kundërpadisë. Prapësimi, si mjet procedural i të paditurit ndaj një padie të ngritur kundër tij, parashikohet në mënyrë implicite në nenin 31/2 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “Padia i jep të drejtën palës tjetër kundërshtare për të diskutuar mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi”. Nisur nga formulimi i dispozitës së mësipërme, rezulton se i padituri në një gjykim të filluar mund t’i kundërshtojë paditësit arsyet që nga pikëpamja e faktit apo e ligjit, i bëjnë të papranueshme kërkimet e tij të paraqitura me anë të padisë. Në rastin e paraqitjes së prapësimit i padituri nuk del me kërkime të veçanta ndaj paditësit, prandaj gjykimi i çështjes përqëndrohet brenda kuadrit të kërkimeve të paditësit të shprehura në objektin e padisë. Sipas nenit 160/1 të Kodit të Procedurës Civile “I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë, ose kur midis tyre mund të bëhet

kompensim”. Në kuptim të dispozitës së mësipërme, kundërpadia është padia e të paditurit që drejtohet kundër paditësit, e paraqitur në një gjykim të filluar. Që padia e të paditurit të cilësohet si kundërpadi dhe të pranohet të gjykohet sëbashku me padinë në gjykimin e filluar duhet të plotësojë të paktën njërin nga dy elementet substanciale të kërkuar nga neni 160/1 i Kodit të Procedurës Civile, lidhjen (koneksitetin) midis kërkimeve dhe/ose mundësinë e kompensimit (ndërshtyerjes) të detyrimeve të ndërsjellta. Në rastin konkret, pala e paditur, shoqëria “BAR RESTAURANT ***” SHPK mund të kishte depozituar kundërpadi sipas rregullave procedurale civile për të paraqitur kërkimet e saj.

Së dyti: Gjykata vlerëson se nga provat e administruara në gjykim si ekstraktet e QKB-së konstatohet se pala paditëse Shoqëria “****” SHPK është shoqëri e cila është krijuar më parë dhe ka emrin tregtar të ngjashëm me markën tregtare “****”, ndërsa shoqëria që ka pasur më përpara të regjistruar markën tregtare e ka pasur emrin tregtar Shoqëria “****” e cila nuk ka lidhje me emrin e markës tregtare “****”.

Për sa më sipër, gjykata arrin në konkluzionin se emri tregtar “*” nuk është emri tregtar i palës së paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK, por është emri tregtar i palës paditëse, *** SHPK.***

Problemi i tretë: A gëzon mbrojtje marka “**”, duke qenë se përbëhet nga një fjalë e fjalorit të zakonshëm në gjuhë të huaj?**

Gjykata vlerëson se markat janë shenja identifikimi në treg dhe në këtë kuptim, funksioni i tyre është të ndihmojë prodhuesin për shitjen e mallit dhe/ose shërbimit dhe, nga ana tjetër të ndihmojë përdoruesin të zgjedhë mallin, apo shërbimin që ai identifikon se është prodhuar nën kontrollin e pronarit të markës, që të mund të mbajë përgjegjësi për cilësinë e tij.

Gjykata bazuar në nenet 140 dhe 141 të Ligjit Nr.9947/2008, vlerëson se një shenjë duhet të plotësojë disa kushte që të konsiderohet markë:

- 1) Të jetë fjalë, disenjim, shkronja, numra, ngjyra, formë mallrash ose paketimesh, tingush ose kombinim i tyre;
- 2) Të jetë e aftë të dallojë mallrat/shërbimet e njërit person nga ato të një personi tjetër;
- 3) Të paraqitet grafikisht;
- 4) Të ketë karakter dallues.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se marka “****” në pronësi të palës paditëse, shoqërisë “****” SHPK me Nr. regjistrimi ***, e llojit “Fjalë dhe figurë”, e cila mbron ngjyrën blu, me gërma të theksuara në ngjyrën blu, paraqitet grafikisht, përmban shkronja dhe ngjyra, është e aftë të dallojë shërbimet e njërit person nga ato të një personi tjetër dhe ka karakter dallues. Ndonëse termi “****” nënkupton “shesh i madh i hapur publik”, përveçse është në gjuhë të huaj, italisht, kjo fjalë përdoret për të karakterizuar shërbimin e akomodimit të përkohshëm, barit, restorantit etj., nuk është markë përshkruese që identifikon shërbimin apo mallin e ofruar, si dhe nuk bie në kundërshtim me shkaqet absolute të refuzimit të regjistrimit, të parashikuar nga neni 142 i ligjit Nr.9947/2008. Kjo markë është më tepër një markë arbitrare, e cila nuk ka ndonjë lidhje kuptimore me shërbimin e ofruar. Gjykata thekson se sipas doktrinës të së drejtës së pronësisë industriale “Marka arbitrare” është ajo markë tregtare ose shërbimi që përbëhen nga fjalë ose simbole që nuk kanë të bëjnë me produktet ose shërbimet që ofrohen. Marka arbitrare është një fjalë e vërtetë, që gjendet në fjalorin e përditshëm, por fjala përdoret në mënyrë të tillë që të mos ketë lidhje me kuptimin. Kështu pra, emri “****”

ose “shesh i madh i hapur publik” nuk ka lidhje kuptimore me akomodimin, shërbimin e barit apo atë të restorantit.

Për sa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se marka “”, gëzon mbrojtje nga e drejta e pronësisë industriale, pavarësisht se përbëhet nga një fjalë e fjalorit të zakonshëm në gjuhë të huaj.***

Problemi i katërt: A ekzistojnë shkaqe për deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare * me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT ***” SHPK?**

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje Gjykata do të marrë në analizë markat tregtare të regjistruara pranë palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë Industriale si më poshtë:

Gjykata për të arritur në përfundimin nëse ekzistojnë shkaqe për deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës Nr. regjistrimi *** i referohet nenit 143 të ligjit Nr.9947/2008, konkretisht gërmës “b” të pikës 2 të tij.

Gjykata vlerëson se pala paditëse gëzon legjitimitet aktiv në ngritjen e kërkesëpadisë, nëse ajo kërkon që të mbrojtë të drejtat e një marke tregtare të regjistruar (*pronari i markës*), të cilat çënohen nga një markë tregtare e një shoqërie tjetër (*e regjistruar më vonë*), e cila duhet të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën e palës paditëse, tregton të njëjtin produkt, si dhe ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit të publiku, për shkak të ngjashmërisë së tyre. Pra, pronari i markës së regjistruar mund të kërkojë shfuqizimin e markës së regjistruar nëse plotësohen disa kushte dhe pretenduesi duhet të provojë përpara gjykatës se:

i. Është pronar i markës së regjistruar me një datë të paraqitjes (prioriteti) të mëparshme

Në rastin konkret, rezultoi se pala paditëse, Shoqëria *** SHPK legjitimohet aktivisht në ngritjen e kërkesëpadisë, pasi provohet se markat në pronësi të saj, konkretisht Marka *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë dhe figurë”, dhe Marka *** me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë dhe figurë”, janë depozituar, e për rrjedhojë kanë përfituar mbrojtje më herët në kohë, respektivisht në datat *** dhe ***. Ndërsa Marka ***, në pronësi të palës së paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK, me Nr. regjistrimi ***, lloji “Fjalë standarte”, është depozituar në datën ***, pra për afërsisht dy vjet e gjysmë pas fitimit të mbrojtjes së markës me Nr. regjistrimi *** dhe tetë vjet e gjysmë pas fitimit të mbrojtjes së markës me Nr. regjistrimi ***, të cilat janë në pronësi të palës paditëse.

ii. Ekziston identiteti i dyfishtë midis markave objekt gjykimi (Krahasimi i markave)

Gjykata kur analizon ngjashmërinë midis dy markave, nuk krahason një element të një marke me një element të një marke tjetër. Krahasimi konsiston në shqyrtimin e markës në tërësinë e saj, duke krahasuar çdo element, e nëse nga ky krahasim del një rezultat i parëndësishëm, atëherë gjykata vlerëson nëse ka ngjashmëri duke u bazuar në elementin mbizotërues të tyre. Ky i fundit është ai që mbizotëron në imazhin e markës, është ai element që konsumatorëve/përdoruesve iu mbetet në mendjen e tyre.

a- Ngjashmëri vizuale

Gjykata vlerëson se në krahasimin e ngjashmërisë vizuale të dy markave, së pari duhet të mbahet parasysh se edhe midis një marke “fjalë” dhe një marke “figurë” mund të bëhet krahasimi, pasi të dy këto lloje markash paraqiten grafikisht dhe krijojnë një perceptim vizual.

Në rastin konkret, gjykata konstaton se Marka *** me Nr.regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur është i llojit “Fjalë standarte”, nuk ka asnjë ngjyrë të mbrojtur ndërsa Marka *** me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës paditëse, është i llojit “Fjalë dhe figurë”, dhe ka të mbrojtur ngjyrën “blu”. Kjo e fundit, duke u pasqyruar grafikisht me gërma të theksuara në ngjyrën blu, pasqyron një shenjë, e cila tërheq vëmendjen e çdo përdoruesi/konsumatori i zakonshëm dhe krijon në perceptimin e tij objekte që kanë të njëjtën ngjyrë. Ndërsa marka në pronësi të palës së paditur me Nr. regjistrimi *** është vetëm si fjalë, pa ngjyra të mbrojtura, e cila pasqyrohet në ngjyrë të zezë. Konstatohet se ka ngjashmëri midis gërmave kapitale të kombinuara “P”, “I”, “A”, “Z”.

Ndërsa përse i përket markës me Nr.regjistrimi *** në pronësi të palës paditëse, ajo dallon nga marka Nr.regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur, pasi e para ka një paraqitje grafike në tri ngjyra, përkatësisht: blu të bardhë dhe të kuqe, si dhe përbëhet nga një delfin, viza të drejta, të valëzuara, gërma të lidhura me element figurativ, gërma të nënvizuara që mbivendosen. Gërmat kapitale të kombinuara janë “P”, “A”, “Z”, ndërsa ngjyrat mbizotëruese janë: e kuqe dhe blu. Po ashtu, në paraqitjen grafike të markës së palës paditëse me Nr. *** pasqyrohet edhe togfjalëshi “bar-restorant”, i cili ndonëse nuk gëzon mbrojtje, perceptohet vizualisht nga përdoruesi. Megjithatë, ka një ngjashmëri të një shkalle jo të ulët midis markave të krahasuara, veçanërisht midis markës me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës së paditur, dhe markës me Nr. regjistrimi *** në pronësi të palës paditëse.

b- Ngjashmëri fonetike

Në krahasimin e ngjashmërisë fonetike gjykata do të analizojë nëse markat e krahasuara tingëllojnë njësoj apo përafërsisht njësoj. Sipas praktikës gjyqësore evropiane, përdoruesi përgjithësisht i kushton vëmendje më të madhe fillimit të një marke se sa fundit të saj. Prandaj duhet të konsiderohet se markat e krahasuara janë, në mënyrë të natyrshme, shumë të ngjashme ose identike nëse përdoruesi përkatës shqipton vetëm formën e shkurtuar të markës, duke mos shqiptuar fjalët e përgjithshme “bar restorant”, si fjalë që nuk gëzojnë mbrojtje pasi tregon karakteristika të shërbimit. Në rastin konkret, forma e shkurtuar e të dyja markave tingëllon njësoj. Megjithatë, duke qenë një fjalë në gjuhë të huaj, kjo është në varësi të përdoruesit/konsumatorit/publikut që e shqipton, pasi mund të shqiptohet “****”, duke shqiptuar “i” si “j” dhe “zz” si “c”, ose “piaza”, duke mos e shqiptuar njërën “z”. Megjithatë, gjykata vlerëson se ngjashmëria në shqiptimin e formës së shkurtuar të markës, padyshim që është e lartë.

c- Ngjashmëri konceptuale

Gjykata vlerëson se markat janë konceptualisht identike ose të ngjashme kur publiku i percepton ato si të njëjta ose me një përmbajtje kuptimore të ngjashme. Ngjashmëria konceptuale është gjithashtu e mundur midis markave të llojit “fjalë“ në gjuhë të huaj. Mjafton që perceptimi i një kuptimi të përbashkët të markave të dallohet nga një pjesë e rëndësishme e publikut përkatës. Në rastin konkret, markat e marra në krahasim janë në gjuhë të huaj dhe kanë të njëjtën përmbajtje e kuptim. Fjala “****” nënkupton një shesh të madh publik ose treg, në një qytet ose shtet. Etimologjia e kësaj fjale vjen nga gjuha italiane, pra “****” “shesh”.

*Si përfundim, rezulton se midis markave të krahasuara ngjashmëria fonetike dhe ajo konceptuale janë në shkallë të lartë, ndërsa ajo vizuale paraqet disa element dallues në paraqitjen grafike dhe në ngjyra vetëm përse i përket markës Nr. regjistrimi *** në krahasim me markën e regjistruar në emër të palës së paditur .*

iii. Ekziston identiteti i dyfishtë midis produkteve/shërbimeve objekt gjykimi (Krahasimi i mallrave/shërbimeve)

Me qëllim vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve në fjalë, gjykata çmon se duhet të mbahen parasysh të gjitha karakteristikat e mallrave ose shërbimeve, të tillë si: natyra e mallit/shërbimit; qëllimi i mallit/shërbimit; mënyra e përdorimit të tyre; konkurrueshmëria e mallrave ose shërbimeve me njëri-tjetrin/njëra-tjetrën apo plotësimi i njëri-tjetrit/njëra-tjetrës. Karakteristikë tjetër që mund të mbahet në vëmendje janë mënyrat e ofrimit të mallrave/shërbimeve.

Në rastin konkret, marka *** me Nr. regjistrimi *** dhe marka *** me Nr. regjistrimi *** , të cilat rezultojnë në pronësi të palës paditëse, *** SHPK, janë regjistruar për këto mallra e shërbime: Hotel, motel, dhënie me qira të pajisjeve për restorante. Restorant, self-service, (vetëshërbim); Snack bar, bar. Dhënie me qira salla për konferenca, dhënie me qira të ambjentëve për akomodim të përkohshëm. Ndërsa, marka *** me Nr. regjistrimi *** , në pronësi të palës së paditur, BAR RESTAURANT *** është regjistruar për këto mallra e shërbime: Shërbime të akomodimit të përkohshëm, shërbime bari dhe shërbime restoranti. ***Pra, rezulton se shërbimet që ofron pala e paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK, janë të njëjta me ato të ofruara nga pala paditëse, *** SHPK.***

iv. Ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku;

Rreziku që publiku mund të besojë se mallrat ose shërbimet në fjalë janë produkt i së njëjtës shoqëri tregtare apo shoqërive të lidhura ekonomikisht, përbën një mundësi të konfuzionit. Gjykata vlerëson se mundësitë e konfuzionit duhet të vlerësohen globalisht, sipas perceptimit të publikut përkatës për shenjat dhe mallrat ose shërbimet në fjalë dhe duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë për rrethanat e çështjes, në veçanti. Në vlerësimin e përgjithshëm të mundësive për konfuzion, duhet të merret parasysh përdoruesi/konsumatori i zakonshëm i kategorisë së mallrave/shërbimeve në fjalë, i cili është i arsyeshëm, i mirëinformuar dhe i vëmendshëm. Duhet gjithashtu të mbahet parasysh se niveli i vëmendjes së përdoruesit të zakonshëm ndryshon sipas kategorisë së mallrave/shërbimeve në fjalë.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se duhet të mbahet parasysh edhe pozicioni territorial që kanë palët ndërgjyqëse, respektivisht pala paditëse *** SHPK ushtron veprimtarinë tregtare

në qytetin e ***, i cili është një nga qytetet bregdetare të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pala e paditur BAR RESTAURANT *** SHPK ushtron veprimtarinë tregtare në qytetin e Tiranës, pra në kryeqytet. Të dy qytetet janë në kufi me njëri-tjetrin. Kësisoj, mundësitë e konfuzionit duhet të analizohen duke marrë në konsideratë përdoruesin e zakonshëm që përfiton shërbime apo mallra nga secila prej shoqërive tregtare, në secilin prej qyteteve. Nga përmbajtja e ekstraktit historik të shoqërive tregtare palë ndërgjyqëse vërehet se ato nuk kanë vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit, përveç zyrës qendrore, respektivisht për palën paditëse në qytetin e ***, ndërsa për palën e paditur në qytetin e Tiranës. Megjithatë, secila prej palëve ndërgjyqëse, për administrimin e shoqërisë mund të vendosë hapjen e degëve dhe/ose zyra të përfaqësimit të shoqërisë, në rrethe të tjera të territorit shqiptar, kësisoj kjo do të sillte konfuzion tek konsumatori/përdoruesi ose ndërlidhje të shoqërive me njëra - tjetrën. Gjykata çmon të theksojë parimin e njohur në fushën e së drejtës së pronësisë industriale, i cili është parimi i mbrojtjes së markës në një territor të caktuar. Ky parim nënkupton me togfjalëshin “një territor të caktuar” territorin e një shteti, dhe jo ndarjet gjeografike brenda tij siç janë njësitet administrative, bashkitë apo qarqet.

Përsa më sipër, gjykata arrin në këto konkluzione:

- **Pala paditëse, shoqëria “****” SHPK gëzon legjitimitet aktiv, pasi markat në pronësi të saj janë marka të regjistruara më parë;**
- **midis markave të krahasuara përkatësisht Nr. regjistrimi *** dhe Nr. regjistrimi ***, në pronësi të palës paditëse, shoqëria *** SHPK nga njëra anë dhe marka Nr. regjistrimi ***, në pronësi të palës së paditur, shoqëria BAR RESTAURANT *** SHPK, nga ana tjetër, ngjashmëria fonetike dhe ajo konceptuale janë në shkallë të lartë, ndërsa ajo vizuale paraqet disa elemente dalluese në paraqitjen grafike dhe në ngjyra;**
- **shërbimet që ofron pala e paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK, janë të njëjta me ato të ofruara nga pala paditëse, *** SHPK, konkretisht kategoria e mallrave dhe shërbimeve e klasifikuar me Nr.43;**
- **si dhe ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek publiku;**

e për rrjedhojë, referuar gërmës “b” pika 2 e nenit 143 e Ligjit Nr.9947/2008, jemi përpara rastit të deklarimit të pavlefshmërisë së regjistrimit të markës së regjistruar më vonë, pra markës me Nr.regjistrimi *** në *pronësi të palës së paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK.*

Problemi i pestë: A përbën marka në pronësi të palës së paditur, shoqërisë “BAR RESTAURANT *” SHPK, marka me Nr. regjistrimi *** markë të mirënjohur?**

Gjatë gjykimit, pala e paditur, shoqëria BAR RESTAURANT *** SHPK pretendoi se marka “****” e regjistruar në pronësi të saj është markë e mirënjohur e për këtë arsye, ajo nuk cënon markat e regjistruara në pronësi të palës paditëse. Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale nuk është depozituar nga pala e paditur, një kërkesë për regjistrimin si të mirënjohur të markës “****” fakt ky që provohet me shkresën Nr. *** Prot, datë *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Megjithatë, gjykata çmon se për t’i dhënë përgjigje pyetjes nëse marka në pronësi të palës së

paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK është markë e mirënjohur, fillimisht do të trajtojë: kuptimin e markave të mirënjohura; mënyrën sesi përcaktohet marka e mirënjohur; cili është autoriteti përgjegjës për kualifikimin e një marke si të “mirënjohur”; dhe cila palë ka barrën e provës për të përcaktuar nëse një markë është e mirënjohur.

a. Çfarë janë markat e mirënjohura?

Marka të mirënjohura tregtare ose shërbimi janë ato marka që kanë një nivel të lartë të njohjes (Notoirement connue) në një territor të caktuar. Procesi kompleks i përcaktimit nëse një markë është e mirënjohur ose jo përfshin elemente sasiore dhe cilësore. Një markë nuk mund të konsiderohet e mirënjohur nëse nuk njihet në një shtrirje të caktuar të një territori ose në një shkallë të caktuar se çfarë ajo markë përfaqëson. Rëndësia e një marke të mirënjohur qëndron në faktin se ajo sjellë vlera të mëdha tregtare për pronarët e markës tregtare. Regjistrimi dhe përdorimi i paautorizuar i një marke të tillë është shkelje e markës tregtare. Përdorimi i paautorizuar i saj krijon konfuzion në lidhje me cilësinë e produktit tek konsumatori/përdoruesi dhe dëmton në këtë mënyrë reputacionin e markës. Shumë shtete mbrojnë markat e mirënjohura të paregjistruara në zbatim të detyrimeve të tyre ndërkombëtare nën Konventën e Parisit. “Konventa e Parisit” është konventa “Për mbrojtjen e pronësisë industriale”, e miratuar në Paris më 20 mars 1883, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme. Nuk janë vetëm shoqëritë tregtare të mëdha ato që mund të kenë marka të mirënjohura, por edhe biznese të vogla të mesme mund të kenë marka që gëzojnë njohje tek përdoruesit/konsumatorët.

Pika 4 e nenit 156 të ligjit Nr.9947/2008 parashikon se të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë. Neni 4, pika 13, i Ligjit 9947/2008 parashikon se: *“Markë e mirënjohur” është marka, në kuptimin e parashikuar në nenin 6 bis të Konventës së Parisit, e njohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenet e këtij ligji.* Neni 6 bis “Markat e Mirënjohura” i Konventës së Parisit, parashikon se: *“(1) Vendet e Bashkimit të Parisit ndërmarrin, ex officio, në rast se legjislacioni i tyre/lejon, ose me kërkesë të një pale të interesuar, të refuzojnë ose të fshijnë regjistrimin dhe të ndalojnë përdorimin e një markë tregtare e cila është një riprodhim, imitim, ose përkthim, përgjegjës për shkaktimin e konfuzionit, të një marke të konsideruar nga autoritetet kompetente të vendit të regjistrimit, ose që konsiderohet zakonisht si e mirënjohur në atë vend, si të jetë e njëjta markë e një personi që ka të drejtën e përfitimeve nga kjo Konventë dhe që është përdorur për mallra identike ose të ngjashme. Këto dispozita do të zbatohen gjithashtu kur pjesa thelbësore e markës është një riprodhim e çfarëdolloj markë të tillë të mirënjohur ose një imitim përgjegjës për krijimin e konfuzionit. (2) Një periudhë prej të paktën pesë vjetësh nga data e regjistrimit, do të lejohet për të kërkuar anulimin e një markë të tillë. Vendet e Bashkimit të Parisit mund të parashikojnë një afat brenda të cilit ndalimi i përdorimit mund të kërkohej. (3) Asnjë afat kufizues nuk do të vendoset për të kërkuar fshirjen ose ndalimin e përdorimit të markave të regjistruara ose të përdorura në keqbesim”.*

b. Si përcaktohet marka e mirënjohur?

Pika 6 e nenit 143 të Ligjit Nr.9947/2008 parashikon se: “Kriteret në lidhje me markat e mirënjohura përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat”. Neni 58 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 315, datë 31.5.2018, “Për miratimin e Rregullores për Markat” përcakton se: “autoriteti kompetent në përcaktimin e markave të mirënjohura do t’i

referohet rekomandimit të përbashkët lidhur me dispozitat për mbrojtjen e markave të mirënjohura të miratuar nga Asambleja e Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”. Rekomandimi i Përbashkët mbi përcaktimin e dispozitave për mbrojtjen e markave të mirënjohura, në nenin 2 të tij parashikon:

“(1) Faktorët që merren në konsideratë (a) Për të përcaktuar nëse një markë tregtare konsiderohet si markë e mirënjohur, autoriteti përgjegjës duhet të marrë në konsideratë çdo rrethanë nga e cila mund të nxirret konkluzioni se marka tregtare është e mirënjohur.

(b) Veçanërisht, autoriteti përgjegjës do të konsiderojë informacionin që i është paraqitur atij duke patur parasysh faktorët nëpërmjet të cilëve mund të nxirren konkluzione se marka tregtare është ose jo, e mirënjohur, duke përfshirë por pa u kufizuar në informacionin e mëposhtëm:

1. shkallën e njohurive apo njohjen e markës tregtare në sektorin e publikun përkatës;
2. kohëzgjatjen, shtrirjen dhe hapësirën gjeografike në të cilën përdoret marka tregtare;
3. kohëzgjatjen, shtrirjen dhe hapësirën gjeografike të çdo promovimi të markës tregtare duke përfshirë edhe reklamën ose publicitetin dhe prezantimet, në panairë apo ekspozita, e mallrave dhe/ose shërbimet për të cilën marka zbatohet;
4. kohëzgjatja dhe hapësira gjeografike e çdo regjistrimi dhe/ose e çdo aplikimi për regjistrim, të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;
5. të dhënat e vënies në zbatim në mënyrë të suksesshëm të të drejtave të lidhura me markën tregtare dhe në veçanti shkallën në të cilën marka është njohur si e mirënjohur nga autoritetet përgjegjëse;
6. vlera e lidhur me markën tregtare.

(c) Faktorët e mësipërm, të cilët janë udhëzime për të ndihmuar autoritetet përgjegjëse për të përcaktuar nëse marka tregtare është një markë e mirënjohur, nuk janë parakushte për arritjen e përcaktimit. Përkundrazi, përcaktimi i çdo rasti do të varet sipas situatave të veçanta të atij rasti. Në disa raste të gjithë faktorët mund të jenë të rëndësishëm. Në raste të tjera disa nga faktorët do të jenë të rëndësishëm. Në disa raste të tjera asnjë nga faktorët nuk është i rëndësishëm, dhe vendimi mund të bazohet në faktorë shtesë të cilët nuk janë të listuar në nën-paragrafin (b), me sipër. Faktorë të tillë shtesë mund të jenë të rëndësishëm, vetëm ose në kombinim me një ose me shumë nga faktorët e listuar në nënparagrafin (b), më sipër.

(2) Sektori i Publikut Përkatës: (a) sektorët e publikut përkatës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen domosdoshmërisht në:

- (i) konsumatorët aktuale dhe/ose të mundshëm të llojit të mallrave dhe/ose shërbimet të cilave marka tregtare u zbatohet;
- (ii) personat e përfshirë në kanalet e shpërndarjes së llojit të mallrave dhe/ose shërbimet të cilave marka tregtare u zbatohet;
- (iii) qarqet e tregtarëve që kanë të bëjnë me llojin e mallrave dhe/ose shërbimet të cilave marka tregtare u zbatohet.

(b) Kur një markë tregtare përcaktohet se është e mirënjohur në të paktën një sektor të publikut përkatës të një Shteti Anëtar, marka tregtare do të konsiderohet nga Shteti Anëtar si markë tregtare e mirënjohur.

(c) Kur një markë përcaktohet se është e njohur në të paktën një sektor të publikut përkatës të një Shteti Anëtar, marka tregtare do të konsiderohet nga Shteti Anëtar si markë e mirënjohur.

(d) Një Shtet Anëtar mund të përcaktojë që një markë tregtare është mirënjohur, edhe në qoftë se marka tregtare nuk është e mirënjohur, ose nëse Shtetet Anëtare zbatojnë nenparagrafin (c), i njohur, në çdo sektor të publikut përkates të Shtetit Anëtar.

(3) Faktorë të cilët nuk do të kërkohen] (a) Një Shtet Anëtar nuk do të kërkojë, si kusht për të përcaktuar nëse një markë tregtare është markë tregtare e mirënjohur:

(i) që marka tregtare është përdorur, ose marka është regjistruar ose aplikimi për regjistrimin e markës tregtare është dorëzuar në lidhje me Shtetin Anëtar;

(ii) që marka tregtare është e mirënjohur në, ose marka është regjistruar ose që një aplikim për regjistrim të markës tregtare është dorëzuar në lidhje me Shtetin Anëtar; ose

(iii) që marka tregtare është e mirënjohur nga publiku i gjerë në Shtetin Anëtar.

(b) Pavarësisht nga nënparagrafi (a) (ii), një Shtet Anëtar mundet, që në qëllim të zbatimit të paragrafit (2) (d), të kërkojë që marka tregtare të jetë e mirënjohur në një ose më shumë juridiksione të ndryshme nga Shteti Anëtar.”

Gjykata vlerëson se shkalla e njohjes së një marke mund të përcaktohet nëpërmjet anketave me konsumatorët/përdoruesit ose sondazheve.

Kohëzgjatja, shkalla dhe zona gjeografike e çdo përdorimi të markës janë treguesë shumë të rëndësishëm për përcaktimin nëse marka është ose jo një markë e mirënjohur nga sektori përkatës i publikut. Megjithatë, përdorimi i markës në territoret fqinje, në territoret në të cilat flitet e njëjta gjuhë ose gjuhë të njëjta, në territoret të cilat mbulohen nga të njëjtat media (media vizive ose media e shkruar) ose në të njëjtin territor që ka marrëdhënie të ngushta tregtare mund të jenë relevante për krijimin e njohjes së asaj marke.

c. Cili është autoriteti përgjegjës për të përcaktuar një markë si të mirënjohur?

Sipas nenit 1 të Rekomandimit “autoriteti kompetent” nënkupton një autoritet administrativ, gjyqësor, dhe pothuajse gjyqësor (kuazi gjyqësor) të një Shteti Anëtar, i cili është kompetent për të përcaktuar nëse një markë është e mirënjohur ose për të aplikuar mbrojtjen e një marke të mirënjohur. Natyra juridike e “autoritetit kompetent” varion sipas sistemeve të brendshme të Shteteve Anëtare. Përkufizimi është i gjerë me qëllim që të përshtatet në të gjithë sistemet e Shteteve Anëtare. Në nenin 2 të VKM Nr.315/2018 përcaktohet se termi “Autoriteti kompetent” nënkupton autoritet administrativ ose gjyqësor, i cili është kompetent të përcaktojë nëse një markë është e mirënjohur apo të garantojë mbrojtjen e markave të mirënjohura.

Pra, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë për të përcaktuar nëse një markë është e mirënjohur ose jo. Në rastin konkret, gjykata vëren se pala paditur ndonëse pretendon se marka në pronësi të saj përbën markë të mirënjohur, ajo nuk paraqiti prova me anë të së cilës të bazonte pretendimin e saj.

Gjykata bazuar në nenin 12 të K.Pr.Civile vlerëson se pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që të paraqesë prova që të vërtetojë pretendimin e saj. Gjykata, mban parasysht çdo rrethanë që i paraqitet, e cila tregon se marka është e mirënjohur. Një sërë informacionesh listohen në gjermën “b” të pikës 1 të Rekomandimit të Përbashkët, por Gjykata nuk mund të kërkojë kryesisht paraqitjen e provave për të vërtetuar faktin e qënies së markës së mirënjohur. Zgjedhja se çfarë informacioni apo prove do të paraqitet në proces është në vullnetin e palës që kërkon të mbrojë markën si markë të mirënjohur.

Në rastin konkret, pretendimi i palës së paditur, BAR RESTAURANT *** SHPK, se marka “***” është markë e mirënjohur mbeti i paprovuar.

Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Ajo duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët të marra në seancë gjyqësore, duke i çmuar ato në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.

Përsa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se pala e paditur shoqëria “BAR RESTAURANT ****” SHPK, nuk paraqiti sondazhe të kryera në lidhje me markën tregtare “****”, për të vërtetuar pretendimet e saj në lidhje me faktin që kjo markë është markë e mirënjohur.

Nga sa më sipër gjykata konkludon në pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga pala paditëse duke:

1. Deklaruar të pavlefshëm regjistrimin e markës tregtare “****” Numri i Regjistrimit ***, datë regjistrimi *** me datë mbarimi mbrojtje *** me pronar Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, me adresë ***.
1. Urdhëruar Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të ç`regjistrojë nga regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, të markës tregtare, “****” Numri i Regjistrimit ***, datë regjistrimi *** me datë mbarimi mbrojtje *** me pronar Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, me adresë ***.
1. Detyruar palën e paditur Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, të ndalojë përdorimin dhe publikimin e markës tregtare “****” ShPK në ambientet ku ushtron veprimtarinë e saj.

Së fundmi, gjykata bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se padia u pranua vlerëson se duhet t`ia ngarkojë shpenzimet palës së paditur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 126, 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

- 1) Pranimin e kërkesë padisë.
- 2) Deklarimin e pavlefshëm të regjistrimit të markës tregtare “****” Numri i Regjistrimit ***, datë regjistrimi *** me datë mbarimi mbrojtje *** me pronar Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, me adresë ***.
- 3) Urdhërohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale të ç`regjistrojë nga regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, të markës tregtare, “****” Numri i Regjistrimit ***, datë regjistrimi *** me datë mbarimi mbrojtje *** me pronar Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, me adresë ***.
- 4) Detyrimin e palës së paditur Shoqëria “BAR RESTAURANT ****” ShPK, të ndalojë përdorimin dhe publikimin e markës tregtare “****” ShPK në ambientet ku ushtron veprimtarinë e saj.
- 5) Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- 6) Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve

duke filluar ky afat nga nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. Për palën e paditur në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

1. U shpall sot më datë 26.09.2018 në Tiranë.

SEKRETARE

GJYQTARE

Ejvisa

Anila KARANXHA

MOLLA

Shpenzime gjyqësore të parapaguara nga pala paditëse

Taksë gjyqësore	3,000 lekë
Totali	3,000 lekë

Shpenzime gjyqësore të parapaguara nga gjykata

Shpenzime njoftimi	1,000 lekë
Totali	1,000 lekë